



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 09 mars 2021, në mbledhjen e XXXIV-të (tridhjetë e katër) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Avni Fetahu drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Fevzi Jetullahu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Bahrije Shatrolli Mehmeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, Pajtim Balaj, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje, ndër të tjera shtoi, nëse ka dikush diçka për të shtuar urdhëroni.

z.Patriot Rudari, theksoi, dëshiroj të deklarohej se nga sot jam pjesë e subjektit politikë Lëvizja Vetëvendosje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi konstatoi se Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar për këtë mbledhje

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 01 shkurt 2021

Njëzëri miratohet procesverbali sipas kësaj pike.

2. Propozim Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës

➤ **Propozim vendimi për vënie në diskutim publik**

znj.Bahrije Shatrolli - Mehmeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, bazuar në Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK nr.09/2020 për caktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, Komuna mund të jap në shfrytëzim pronën e paluajtshme për më pak se 1 (një) vit, mirëpo ashtu siç thuhet në këto akte, procedurat dhe forma për dhënien në shfrytëzim për më pak se 1 (një) vit rregullohen dhe përcaktohen me rregulloren komunale. Materialin besoj që e keni marr me kohë, kështu që nëse ndokush dëshiron të shtoj diçka mund ta bëjë një gjë tillë sepse pronat e paluajtshme të cilat nuk mund të jepen për një periudhë më të gjatë mund të jepen për më pak se një vit.

z.Mehmet Gashi, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, e rekomandojmë këtë pikë për shqyrtim në Kuvend.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e rekomandojmë për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po ashtu edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së i rekomandojmë Kuvendit, por dëshiroj të ngris edhe njëherë një çështje sepse është mbledhja e tretë radhazi që në mënyrë zyrtare e kam kërkuar listën e pronave komunale, qoftë në fshatra qoftë në qytet, por më konkretisht në qytet të cilat janë të dhëna me qira, atyre që janë të uzurpuara dhe pronave për të cilat janë krijuar borxhe. Pra ne absolutisht i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtimin e kësaj pike të propozuar, mirëpo edhe njëherë lus që deri në mbledhjen e ardhshme të më dorëzoni një kopje/listë të pronave që i ceka, në të kundërtën jam i detyruar që të bëjë një kërkesë zyrtare me shkrim për qasje në dokumente zyrtare.

znj.Bahrije Shatrolli - Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, lista e përgjithshme e pronave komunale duhet të publikohet në web-faqe të Komunës dhe në këtë aspekt na është marrë shumë kohë me identifikimin e tyre, por ende jemi duke e përgatitë listën e përgjithshme të pronave komunale dhe në momentin që është e përfunduar ne do e publikojmë në ueb-faqen e Komunës. Pra vetëm se është një procedurë paksa më e gjatë ngase është një numër shumë më i madh i pronave dhe duhet të bëhet identifikimi i gjithsecilës, por jemi duke punuar në këtë aspekt.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të ljamëruar për të marrë fjalën, lus parafolësen që të propozon edhe datat e diskutimit dhe debatit publik të cilat janë në kuadër të propozim vendimit përkatës për vënie në diskutim publik. Pra se kur mendon të bëjë një gjë të tillë për asye të lehtësimit të punës së Kuvendit pastaj që të mos merremi më me këtë pjesë por të shkoj me rekomandime nga kjo mbledhje.

znj.Bahrije Shatrolli - Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ, theksoi, mendoj që kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë 15 mars 2021 nderi me 15 prill 2021, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më datë 24 mars 2021 në ora 10:00.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozim vendimit për vënie në diskutim publik Propozim Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, duke mbështetur edhe propozimin që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, përkatësisht nga data 15 mars 2021 deri më 15 prill 2021, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 24 mars 2021 duke filluar në ora 10;00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës.

3. Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës

➤ Propozim vendimi për vënie në diskutim publik

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, para vetës keni Draft Rregulloren për  rkujdesjen dhe mbrojtjes e f mij s n  Komun n e Podujev s e cila ka p r q llim mbrojtjes s  f mij s nga t  gjitha format e dhun s fizike dhe mendore, abuzimit, keqp rdorimit, shfryt zimit, neglizhimit apo ndonj  form  tjet r q  v  n  rrezik jet n, sigurin , sh ndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e f mij s, p rcaktimit t  detyrave dhe p rgjegj sive t  subjekteve p r mbrojtjen e f mij s, si dhe m nyr s s  koordinimit, raportimit dhe bashk punimit t  tyre me q llim t  kontributit n  sistemin p r mbrojtjen e f mij s, si dhe kontributit n  krijimin e nj  Komun  Mike p r F mij ,  shtje k to t  cilat p rcaktohen edhe n  ligjin p rkat s p r mbrojtjen e f mij s.

Si  e dini kjo draft rregullore  sht  hartuar nga organizata ATRC (Advocacy Training & Resource Center) n  bashk punim edhe me organet p rkat se t  nivelit qendror, si model p r t  gjitha Komunat e Republik s s  Kosov s, n  m nyr  q  t  miratohen nga Kuvendet e Komunave pas vendosjes s  specifikave p rkat se.

Duke pas parasysh q  ky draft ju  sht  p rcjell  me koh  dhe keni pas  mund si dhe koh  ta lexoni dhe analizoni, prandaj nuk po d shiroj t'ju marr  koh  m  shum  sepse draft rregullorja n  fjal  do t  sjell t s rish n  Kuvend p r shqyrtim dhe miratim final, mir po tani n  k t  faz  kemi t  b jm  vet m me dh nien e p lqimit, n  nj  form , p r v nie n  diskutim publik, ashtu si  edhe  sht  n  materialin e propozim vendimit p r v nie n  diskutim publik i cili sipas legjislacionit n  fuqi duhet t  zgjat t  pakt n 30 dit  nga dita e publikimit.

Koh zgjatja e diskutimit publik kam menduar t  jet  prej 15 mars 2021 deri m  15 prill 2021, do t  thot  30 dite, nd rsa debati publik me qytetar  kam m nuar t  mbahet m  23 mars 2021 duke filluar nga ora 10;00, n  nd rtes n e re t  Komun s, salla e mbledhjeve.

z.Mehmet Gashi, theksoi, i rekomandojm  Kuvendit p r shqyrtimin e k saj pike, meq  e nj jta del n  diskutim publik besoj q  jemi dakord dhe t  arsyesh m k t  pik .

z.Florent Hasani, theksoi, n  em r t  Grupit t  k shilltar ve i LVV-s  i rekomandojm  Kuvendit p r shqyrtim.

z.Rafet Llapashtica, edhe ne Grupi i k shilltar ve nga radh t e PDK-s  i rekomandojm  Kuvendit k t  pik  t  rednit t  dit s.

*Nj z ri i rekomandohet Kuvendit p r shqyrtim dhe miratim t  propozim vendimit p r v nie n  diskutim publik Propozim Rregulloren p r p rkujdesjen dhe mbrojtjen e f mij s, duke mb shtetur edhe propozimin q  diskutimi publik t  zgjat  30 dit , p rkat sisht nga data **15 mars 2021 deri m  15 prill 2021**, nd rsa debati publik me qytetar  t  mbahet m  **23 mars 2021 duke filluar n  ora 10;00 n  sall n e mbledhjeve t  Kuvendit n  nd rtes n e re t  Komun s**.*

4. Propozim Rregullore p r ndryshimin dhe plot simin e Rregullores p r orarin e pun s p r bizneset q  operojn  n  territorin e Komun s s  Podujev s

➤ Propozim vendimi p r v nie n  diskutim publik

z.Pajtim Balaj, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, e paraqiti fjal n hyr s  rreth k saj pike, ndër t  tjera theksoi, besoj q  e keni marr materialin me koh  p r k t  propozim ndryshim t  Rregullores p r orarin e pun s p r bizneset q  operojn  n  territorin e Komun s s  Podujev s. Kryesisht jemi bazuar n  k rkesat q  na jan  ardhur nga shum  biznese, pun tor  dhe

qytetarë për ta ndryshuar këtë rregullore, andaj ne si Drejtori e kemi bërë draftimin e saj në ato pikat ku kemi pas kërkesa gjatë konsultimeve me shumë biznese në takime të ndryshme gjatë javëve të kaluara. Pra ky është vetëm një draft, nuk është version final, besoj që mund të pasurohet me propozime dhe sugjerime të ndryshme të cilat pastaj mund të inkorporohen si propozime që mund vijnë qoftë edhe nga asamblistët qoftë prej qytetarëve në debatin publik gjatë periudhës së diskutimeve publike, prandaj nga Ju kërkohet që të rekomandoni këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit. Sa i përket kohëzgjatjes së diskutimit publik dhe debatit publik me qytetarë ne kemi menduar të jetë 30 ditë, nga data 15 mars 2021 deri më 15 prill 2021, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më 22 mars në ora 10:00.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, natyrisht që ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së e mirëpresim plotësim ndryshimin e rregullores në fjalë me të vetmin arsyetim që ka kërkesa nga bizneset, punëtorët dhe nga të gjithë për plotësimin dhe ndryshimin e kësaj rregulloreje. Ne e dimë që është një rregullore e cila është miratuar para një viti dhe që me unanimitet të plotë e kemi përkrahë duke u bazuar pikërisht në këto arsye, përkatësisht në interesat e punëtorëve edhe të bizneseve, por që natyrisht se për një vit kanë ndodhur shumë gjera siç është pandemia covid-19 dhe shumë gjera tjera pastaj, prandaj një plotësim ndryshim i kësaj rregulloreje është më shumë se domosdoshmëri.

Përtej kësaj, drejtori i DPZHE-së e përmendi që ka pasur diskutime dhe kërkesa nga biznese të ndryshme, por ajo që na pengon neve në fakt është prekja e disa pikave dhe lënja anash e disa të tjerave, sepse kur dëshirojmë ta ndryshojmë do të ishte mirë të përfshihen të gjitha kategoritë e bizneseve dhe pastaj të vendoset në varësi prej kërkesave prej të cilave prandaj do të kemi një propozim konkret që kjo rregullore të mos diktohet paraprakisht në pika të caktuara, por t'i nënshtrohet një plotësim ndryshimi të tërësishëm, pra të ndihen të lirë të gjitha kategoritë që t'i sjellin kërkesat dhe propozimet e tyre dhe pastaj në këtë mënyrë edhe të përcaktohen, të ndryshohen pikat konkrete ose çështjet e caktuara.

Unë e kuptoj që mund të ndryshohen me kalimin kohës dhe gjatë debatit publik, por po na pengon fakti që është diktuar vetëm tek disa kategori të caktuara dhe jo si tërësi ky draft i propozuar për plotësim dhe ndryshim, prandaj edhe kemi propozim konkret që kjo rregullore të shkojë si tërë në diskutim publik për plotësim ndryshim pa u diktuar me pika të caktuara, përndryshe ne pajtohemi edhe me afatet edhe me diskutimin publik të caktuar.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike ashtu siç është sjellë me materialin përkatës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sigurisht që këto rregullore do të pasurohen edhe përgjatë debatit publik dhe besoj që në debatin përfundimtarë që do të mbahet në Kuvend me datën që drejtori e dha, dhe me propozime konkrete të pjesës së Kuvendit por edhe gjatë rrugëtimit 30 ditor. Unë e kam shikuar propozim rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores bazë, por t'ju them të drejtën një rregullore për orarin e bizneseve është në fuqi e cila është propozuar nga DPZHE-së që është bërë para rreth një viti, megjithëse edhe kjo që është në fuqi ka pasur defektet e saja, mirëpo mua tek ky propozim që është sjellë tani, edhe pse ndoshta tani nuk mund të diskutojmë por është mirë që të kihet parasysh sepse rregullorja nxirret nga ligji, çdo rregullore apo udhëzim administrative duhet të jetë në harmoni me ligjin, apo në një fushë konkrete në këtë rast në rregulloren e kaluar ish drejtori e ka sjell një draft rregullore duke u bazuar në takimet me bizneset e Komunës së Podujevës dhe kërkesat e punëtorëve që të kenë një ditë të lirë në javë, kështu ka qenë arsyetimi dhe ne jemi pajtuar edhe pse mendoj që si Kuvend nuk e kemi kryer detyrën për arsye se është marrë specifikisht edhe me ankimet dhe procesverbalet e bizneseve.

Drejtori i DPZHE z.Pajtim Balaj e din saktësisht, mirëpo nuk e di tani sa biznese janë aktive dhe të përgjysmuara në nivel komune, dhe nuk më pëlqej kjo formë dhe madje është edhe e pa pranueshme se nuk bazohet askund në ligj që pas orës 13:00 ditëve të diela bizneset të bëjnë kërkesa në Drejtori që të ju

jepet leja e punës, dhe tani duhet të mendojmë për këtë çështje. Ne jemi për ta lehtësuar punën në aspektin teknik DPZHE-së sepse mendoj që kur të hyjë në fuqi kjo rregullore duhet edhe të funksionalizohet dhe të zbatohet. Orientimisht me sa unë kam mundur të marr një opinion, janë afro 700 biznese në nivel Komune (në fshatra dhe në qytet), dhe duhet të mendoj DPZHE si të lëshoj ato leje, pra nëse janë 700 kërkesa në ora 13:00 të dielën, konkretisht si do të mund t'i lëshoj ato leje, madje vetëm teknikisht. Çështja tjetër që duhet të mendoj Drejtoria e Inspeksionit është se si duhet ta mbikëqyrë punën e këtyre bizneseve me këtë numër të inspektoreve që kanë e që mendoj se është e pamundur, pra jam duke diskutuar para se të kemi diskutimin dhe debatin publik, por mendoj që në këtë kohë që jemi me një gjendje të rënduar ekonomike si biznese, si qytetarë dhe si shtet në përgjithësi, është mirë që vendimi jonë si përfaqësues të qytetarëve të jetë unik dhe i ngjashëm për të gjitha bizneset sepse me biznese nuk mund të bëhet diferencim, që një biznes të punoj deri në ora 13:00 të dielave kurse biznesi tjetër deri në ora 24:00.

Mandej detyrimi i bizneseve me ardhë në zyre të përfaqësimit politik të drejtorit dhe të shikoj se a po ja jap apo jo lejen kjo është e pa pranueshme, e them këtë sepse detyrë e ekzekutivit është që ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit, nëse me ligj janë 40 orë punë duhet të shkoj inspektori të kërkojë gjendjen në biznes ose të paktën edhe punëtorin konkretisht, ajo është e rëndësishme për ne që ta lehtësojmë punën e punëtorit. Gjithherë në Komunën e Podujevës por edhe në Komunitat tjerë, e që jemi ndër 3-4 Komuna që e kemi një rregullore të tillë me të cilën e ndalojmë punën, e që nuk e kanë komunitat tjerë.

Pastaj kjo rregullore kur të hyn në fuqi, dhe për faktin që jemi duke shkuar në drejtim të stinës së verës gjithëherë Drejtoritë përkatëse kanë bërë zgjatje të orarit në verë, përfshirë edhe shfrytëzimin e teracave për shkak të fluksit dhe vizitës nga bashkatdhetarët dhe kjo e ka ngritur qarkullimin ekonomik të bizneseve, por në një formë edhe bizneset edhe kafiteritë edhe gastronomitë tani kanë probleme në tërë Kosovën, mirëpo ne merremi vetëm me Komunën e Podujevës që do të thotë se i ngrisim të hyrat, por nëse e bëjmë këtë diferencim të bizneseve që shembull frizerët apo berberët të punojnë deri në ora 13:00, kurse disa biznese tjerë punojnë deri në ora 23:00, kjo është e pa pranueshme, por sido që të jetë si Grup parlamentar ne do t'i sjellim propozimet tona gjatë debatit publik.

Sido që të jetë nuk do të kisha thënë që propozim rregullorja e re të jetë rrugëtim i rregullores së vjetër për arsye se këto drafte kur përgatiten pastaj shfuqizohet rregullorja ekzistuese paraprakisht, ndërsa Drejtoria nuk do të mund t'i vizitoj të gjitha ato biznese dhe t'i njoftoj me rregulloren e re, e them këtë sepse jemi dëshmitar se faqja zyrtare e Komunës nuk vizitohet nga të gjithë dhe në anën tjetër Komuna e as Drejtoria nuk mund t'i njoftoj të gjithë veç e veç në momentin e hyrjes në fuqi të rregullores së re, pra vetëm në aspektin teknik po flas, ndërsa në aspektin e rrugëtimit të këtij drafti ne do t'i sjellim propozimet konkrete, mirëpo unë mendoj që do të ishte mirë edhe për drejtorin dhe do të dilte edhe më efikas e që do të ishte më e pranueshme qoftë për bizneset qoftë për punëtorët. Pra qëllimi im është për të ndihmuar në këtë çështje, rast konkret edhe drejtorin për arsye se ka mundësi të jetë e pamundur ta bëjë një takim me të gjitha bizneset sepse po t'i pyeten të gjitha sigurisht që nuk do të flasin me një gjuhë të përbashkët, përfshirë këtu edhe punëtorët, prandaj të gjendet një mes.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, theksoi, faleminderit për diskutimet dhe propozimet që i bëtë, besoj që koha për diskutime nuk është sot por me që morët mundin që të elaboroni këtë çështje edhe unë po e marr mundin që të ju përgjigjem. Lidhur me propozimin e znj.Fatlume Jaha, çështja është që ne kemi pasur kërkesa të caktuara, dhe nisma për të ndryshuar dhe për të bërë plotësim ndryshimin e rregullores ka ardhur si kërkesë e njerëzve, ky është vetëm një draft kurse pjesa tjetër mund të ndryshohet pastaj varësisht prej propozimeve që vijnë prej qytetarëve dhe këshilltarëve të Kuvendit, prandaj edhe mendoj se kemi gjetur zgjidhjen ideale, jemi munduar të nisim diçka dhe besoj që kemi me qenë bashkëpunues dhe propozimet e mira që janë në interes të qytetarëve dhe bizneseve do të merren parasysht.

Sa i përket diskutimit të z.Rafet Llapashica, çdo çështje që ka të bëjë me ligjin dhe aspektin ligjor në tërësi do të jemi vazhdimisht në konsultim me zyrën ligjore dhe pse ka pasur jurist të angazhuar në hartimin e kësaj propozim rregulloreje, nuk e di që ky propozim ka ndonjë dis-harmoni me ndonjë ligj të caktuar, nëse ka diçka të tillë ju lutem mos na lini të gabojmë edhe na trego, por sa ne kemi parë nuk ka diçka të tillë.

Sa i përket lejes që mund të jepet pas orës 13:00 ditëve të diela, çështja është që ne kemi pasur shumë kërkesa edhe viteve të kaluara në Kuvend prej zonave që janë pak më turistike, andaj tek kjo pjesë vlen arsyeshmeria e kërkesës që na bëhet. Zona e Orllanit është zonë turistike dhe dita e diel është dita kur tek ata ka më së shumti qarkullim, andaj arsyeshmëria në këtë rast është qarkullimi i madh turizmi në atë zonë dhe mbi këtë bazë lëshohet edhe leja, do të thotë bazohet në një arsye, por nuk mundet kushdo vetëm pse dëshiron ta hap dyqanin dhe ta bëjë një gjë të tillë, pastaj shohim edhe në aspektin e kompetencës, konkretisht ne e përgatitim draftin, Kuvendi e shqyrton dhe e miraton pastaj sigurisht që Drejtoria e Inspeksionit është mekanizmi që e mbikëqyrë orarin e punës në terren, kurse për çështje tjera do të mbahet diskutimi publik dhe besoj se do të kemi kohë pastaj edhe në Kuvend që të diskutojmë, pra mund të jepen konkret propozime, sugjerime dhe vërejtje në shumë forma, (fizikisht, në mënyrë elektronike, në debate publike, në Kuvend) kushdo të beje propozime konkrete.

z.Rafet Llapashica, theksoi, dua të potencoj edhe diçka si për qeverisjen apo Ekzekutivin e nivelit qendror apo lokal, Ligji i punës i përcakton shumë çartë të drejtat e punëtorit në sektorin publik dhe në sektorin privat ato janë të lansuara dhe miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pavarësisht që përfaqësimi në atë Kuvend nuk është dinjitoz për mendimin tim sepse mendoj se janë të pa përgatitur, kurse ne vetëm jemi të detyruar t'i zbatojmë e që jemi në dijeni se nuk zbatohen disa sikurse që është Ligji për duhanin sipas të cilit ndalohet pirja e duhanit në pjesë dhe ambiente të caktuara por që pihet çdo kund, andaj konsideroj se nuk mund të inspektohen gjëra të tilla sikurse që po provohet tani të bëhen ngase vetëm nëse Inspektorët rrinë me letra në dorë duke lëshuar dënime dhe gjopa andaj edhe nuk besoj që mund ta përballoj këtë.

Gjithashtu dëshiroj të potencoj një gjë, shembull, përse një biznes të punoj deri në ora 13:00 të dielave, kurse tjetri deri në 23:00, kah po vie ky diferencim, përse këto ndryshime në orare, unë qëndroj prapa asaj që po e potencoj se vendimi për orarin e bizneseve duhet të jetë unik, ose duhet të lejohet të punojnë e që propozimi im është që në këtë situatë ekonomike që jemi bizneset të punojnë deri në ora 23:00, të gjitha ato të cilat dëshirojnë të punojnë, kush dëshiron ta mbyllë le ta bënë nuk mund ta ndalësh, madje bizneset private mund ta mbyllin krejt biznesin e tyre, taksat i paguajnë.

Rreth këtij propozimi, po i bie paksa politike që po diskutoj sepse ne jemi një subjekt politik dhe mendojmë se çfarë them unë mendon e tërë partia, por të jeni të bindur se propozimet që i bëjë, i bëjë sikur të jem vet në karrigen e juaj drejtor. Nëse do e merrja një vendim për biznese, prej berberëve e deri tek një pompë e benzinës ose një subjekt ekonomik shumë i madh tjetër që punojnë në Komunën e Podujevës, do ta merrja vendim unik sa i përket zbatimit të rregullores edhe të detyrimeve tjera, qoftë financiare qoftë kërkesave tjera. Pra ky është qëllimi për arsye se është biznes dhe taksat i paguajnë njëjtë, qoftë berberi qoftë ETC që i ka më shumë punëtorë, prandaj ne këtu duhet të jemi të kujdesshëm, kjo është ajo që dëshirova ta cek i nderuar drejtor z.Pajtim Balaj, të jesh i bindur që jam për të dal mirë si Komunë n'raport me bizneset për arsye se nuk mund ta diskriminojmë dikë që punon deri në ora 13:00 dhe pastaj të vij në tek ju në zyrë që t'ia lëshoni lejen, kurse tjetri të punoj deri në ora 23:00, kjo është keq, prandaj na detyron tani neve që të ngrisim, e që në fakt po i bie si opozitë, që ta mbrojmë atë biznes, sepse çfarëdo që bëjmë merret vesh shpejt sepse sot informacioni është shumë i shpejtë, po i them këto sepse mua më kanë pyetur njerëzit që pse ne të punojmë deri në ora 13:00 dhe të shkoj të marrë leje, kurse të tjerët deri në ora 23:00, unë ju thash nuk është në funksion dhe zbatim ajo që po e thoni por është Drejtoria, qytetarët, dhe Komuna në përgjithësi që me debate dhe diskutime do të

pasurohet, por sido që të jetë në këtë ambient këtu që jemi si KPF, para se të dal në Kuvend ku do të jenë 35 këshilltarë të Kuvendit të Komunës dhe me procedura tjera.

Pra ky ishte propozim i imi me qëllim të lehtësimit dhe që dhe kur të dalësh në rrugë si drejtor i Drejtorisë nuk do të të thotë askush asgjë ty, ngase je zyrtar përgjegjës, kurse mua nuk më thotë askush asgjë sepse do t'i përgjigjem se nuk jam përgjegjës dhe ditën e mirë, drejtori përkatës është, ta ka bërë vetëm që ka mund ta bëjë, mirëpo nuk është qëllimi im ky, por qëllimi është për t'ju ndihmuar në zbatimin e kësaj rregulloreje.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, edhe pse erdha paksa me vonesë, e kuptova thelbin e asaj se çfarë po kërkohet rreth kësaj pike, konsideroj se rreth kësaj çështje duhet të nisemi prej një parimi dhe mos të veprohet për nga aspekti politik, pozitiv as opozitiv, sepse e kemi një gjendje që është krijuar e që unë nuk e di arsyen se është ardh deri tek kjo dhe çfarë ka ndodh, mirëpo ne po e shohim dhe jemi dëshmitarë të asaj që ditën e diele si Komunë jemi bllokuar sa i përket aspektit biznesor, madje për ta kryer një shërbim më të voglin, përveç atyre që mund të punojnë në mënyrë ilegale, duhet të shkojmë në Lupç për tu furnizuar.

Se a ka nevojë që të ndryshohet Rregullorja në fjalë, unë mendoj që nuk është dashur të shikohet politikisht por të ulemi të gjithë bashkërisht dhe ta analizojmë këtë e që mendimi im është se ka nevojë të ndryshohet kjo Rregullore për arsye që qytetarët të kenë qasje në shërbimet e bizneseve qoftë edhe të dielave sepse shumë prej punëve dhe shërbimeve individuale qytetarët mund t'i kryejnë ditën e diel ngase është ditë pushimi dhe e shfrytëzojnë kohën që t'i kryejnë ato shërbime, e drejtë e cila me këtë Rregullore iu është mohuar atyre e që për mendim timin është një shkelje e të drejtave të njeriut sipas atij vendimi që është marr në atë periudhë kohore, nga kush është iniciuar dhe si ka rrjedh procesi nuk e di por tani e kemi edhe anën tjetër është shumë interesante kjo sepse kemi dy tabore, njeri është që duhet ta lirojmë dhe të punojnë bizneset edhe të dielave, por është edhe tabori i punëtorëve të cilët thonë që mos të ndryshohet kjo pikë sepse po na detyrojnë të punojmë të dielave, gjë që unë këtë çështje nuk e kisha zgjedh me ndalim të punës ditëve të diela por do ta zgjedhja me resorin e Inspeksionit rreth shkeljes apo jo të drejtave të punëtorëve dhe çështjeve tjera nga marrëdhënia e punës, dhe tani sa po e vërej unë në kontekst të kësaj arsye edhe është marrë një vendim i tillë, por që i cili ka paralizuar të gjitha bizneset në nivel Komune, e që mendoj se nuk është bërë mirë, kurse tani në anën tjetër, të bëhen parcializime edhe brenda bizneseve, që kjo bënë, ajo nuk bënë, ose kjo bënë deri në këtë kohë, ajo nuk bënë deri në atë kohë, pra po e them që duhet të ndalemi dhe ta analizojmë këtë çështje por meqë kjo propozim rregullore do të del në diskutim publik unë besoj që bashkërisht të gjithë do të japim kontributet tona dhe do të nxjerrim një zgjedhje / solucion më të mirë dhe më të përshtatshëm.

Nëse më pyetni mua Kryetar Komune se a është mirë dhe a pajtohesh që të mbetet në kompetencë të një drejtori të Drejtorisë t'i lëshohet leja, dhen nëse nuk iu jepet pastaj ai biznes të punoj pa leje, ju them që nuk pajtohem, sepse nuk duhet të mbetet në kompetencë të askujt, është mirë që si propozim tani ta shtyjmë përpara, ta vendosim në diskutim publik dhe të ulemi në diskutim publik t'i marrim krejt reagimet (feedback) që vijnë prej të gjitha kategorive të bizneseve dhe qytetarëve, të ulemi ta analizojmë këtë çështje ose edhe mund ta ngritim një grup prej gjitha subjekteve të Kuvendit të ulemi t'i analizojmë të gjitha ato çështje dhe ta nxjerrim një version final ku do të jenë të kënaqur të gjitha subjektet që përfaqësohen në Kuvend dhe gjitha bizneset dhe qytetarët sepse fundja këtë nuk po e bëjmë për asnjë subjekt politik por për qytetarë sepse të gjithë ne jemi në shërbim të qytetarëve prandaj unë absolut nuk jam që kjo çështje të politizohet dhe t'i jepet kahje politike me logjiken "e kanë bërë ata dhe tani po dojnë ta heqin këta, ose anasjelltas), jo nuk është intenca aty por intenca është që ta gjejmë një zgjidhje një solucion të përgjithshëm që do t'iu ndihmoi dhe që nesër qytetarët të jenë më të kënaqur.

Sa i përket kategorisë së punëtorëve të cilëve ndodh t'iu shkelen të drejtat e punëtorëve sepse detyrohen të punojnë të dielava dhe festave zyrtare, vërtetë ndihem keq dhe më dhimbset ajo kategori, por nuk

guxojmë tani që të gjithë qytetarët t'i sanksionojmë për shkak të shkeljeve që mund t'i bëjnë disa prej bizneseve të pa përgjegjshëm që mund të jenë në nivel komune, prandaj mbetet detyrë e Inspeksionit t'i hulumtoj këto raste se ku po shkelen këto të drejta të njeriut sepse në parim unë fillimisht kam menduar t'i hapur bizneset e vogla por jo edhe këtyre bizneseve pak më të mëdha siç janë ETC, Agnesa, Viva Fresh etj. që kanë numër më të madh të të punësuarve, por prapë është një segregacion / ndarje që u'a bëjmë këtyre të bizneseve të vogla të cilave po i'u japim një mundësi kurse këtyre të mëdhat po i sanksionojmë, gjë që prap nuk është në rregull sepse ndokund mund të bëjmë shkelje dhe ndokujt t'i bëjmë njëfarë përparësie. Prandaj po e them që t'i analizoni mirë këto çështje, ta vëmë në diskutim publik këtë propozim, pse jo edhe ta bëjmë një grup punues prej të gjitha subjekteve dhe gjitha profileve, por sërish e them që si ta vlerësoni Ju. Të merren të gjitha informatat prej diskutimit dhe debateve publik, të bëhen përpjekje që pjesëmarrja e bizneseve dhe kompanive tjera të jetë sa më e madhe, të marrin pjesë sa më shumë, të kenë qasje sa më shumë.

Unë besoj që mund të rregullohen lehtë këto çështje, dhe të modifikohet ose të suspendohet kjo rregullore dhe të aktivizohet Rregullorja e re, dhe le të filloj ashtu siç duhet.

z.Mehmet Gashi, theksoi, më nxiti të marrë fjalën Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, për arsye se Kryetari nuk ishte prezent kur e dhamë propozimin tonë në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së nga znj.Fatlume Jaha, që është propozim shumë i mirë, ne e kuptojmë që ka nevojë të bëhen ndryshime në këtë rregullore për shkak që edhe pse vitin e kaluar është miratuar, është dal në diskutim publik, janë bërë debatet me të gjitha kategoritë e bizneseve, mandej nga Kuvendi i Komunës është marrë vendim me unanimitet, mirëpo gjatë kësaj kohe u pa që ka nevojë për ndryshime, edhe për shkak të pandemisë por edhe për shkaqe tjera. Propozimi ynë ishte që rregullorja të dal në tërësi në diskutim publik, jo vetëm në disa pika / nene, t'i jepet hapësirë edhe bizneseve dhe kategorive tjera nëse pajtohen që të bëhen ndryshime, kështu që të del në diskutim publik si tërësi Rregullorja, të merren të gjitha propozimet që vijnë prej bizneseve dhe në fund ne si Kuvend ta shqyrtojmë dhe miratojmë, pra të bëhet ndryshim në tërësi nëse vlerësohet e arsyeshme, jo vetëm në disa pjesë dhe në mënyrë parciale.

Pastaj ishte edhe kërkesa që përmes kërkesave të bizneseve për disa kategori t'iu lejohet puna, çështje kjo e cila është mirë të rregullohet dhe të parashihet saktë me rregullore dhe mos t'iu lëmë mundësi që pastaj të shfaqen telashe për bizneset atë që e ceku z.Rafet Llapashtica.

Pra këto janë dy ndryshimet që ne i propozuam, kështu që mendoj se si të tillë mund t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, pra fjala është për rregulloren si tërësi.

z.Rafet Llapashtica, propozoi që të shkohet në diskutim publik si tërësi, pastaj mund të pasurohet.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë mbetet që rregullorja në fjalë të shkoj si tërë në diskutim publik, jo vetëm drafti që është sjellë, vetëm për disa pika dhe çështje.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, konsideroj se në diskutim publik dhe me debate publike përfshirë edhe ato në Kuvendin e Komunës dhe në Ekzekutiv, rregullorja në fjalë mund të plotësohet dhe pasurohet me gjëra të mira dhe të nevojshme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa po e vërejë këtu, qëllimi i gjithë subjekteve dhe i anëtarëve të Grupeve dhe i Ekzekutivit është që të nxirret një rregullore e cila do të i përfaqësoj më së miri dhe në mënyrën më të përshtatshme të gjitha bizneset, madje të ketë kujdes edhe që puna e punëtorëve e cila me të vërtetë janë duke e bërë punën më të madhe, madje edhe për Rregulloren aktuale arsyeshmëria kryesore ka qenë që duhet pasur një pikë të tillë sepse vërtetë klasa punëtore janë ankuar shumë se janë jashtëzakonisht të diskriminuar. Unë po ju drejtohem si Kryesues i Kuvendit se këtë javë kam pasur sa e sa thirrje në këtë kuptim nga punëtorët që punojnë në biznese private, me arsyen se a mund të punoni dhe të gjeni konsensus me Kryetarin e Komunës në mënyrë që të gjeni një zgjidhje që të mos diskriminohemi që të paktën ta kenë një ditë të lirë gjatë javës, kështu që unë po mendoj se është një unifikim i të gjithëve që të punohet në këtë drejtim, të ketë vlerësime dhe bazë edhe për punëtorët.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, theksoi, lidhur me ndarjen që i'u kemi bërë bizneseve të vogla dhe të mëdha, krahas kërkesave që kemi pasur dhe bizneseve familjare që mbijetojnë prej kësaj pune, ka qenë që konkurrenca e madhe e këtyre bizneseve të mëdha i shkatërron jashtëzakonisht, kurse sa i përket kërkesave të punëtorëve ne kemi shikuar edhe modele të ndryshme në vende të ndryshme, shembull, në Gjermani apo edhe në Hungari dhe në vendet tjera praktikën që kam parë, ditëve të diela qendrat e mëdha tregtare dhe maketet pushojnë, punojnë vetëm kioskat siç quhen në Gjermani, nuk e di a është në kundërshtim me ligjin, por mendoj që është zgjidhje më të mirë për qytetarët, ndoshta mund të ndodh që nuk përputhet mjaftueshëm mirë me ndonjë ligj por zgjidhje më të mirë dhe më të kënaqshme se kjo për qytetarët unë dyshoj që mundemi me gjete. Sidoqoftë ne e hedhim si në tersi si diskutim rregulloren në fjalë dhe pastaj shohim se çka do del.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozim rregulloren në fjalën përfshirë edhe propozimin që diskutimi dhe debatet publike të bëhen në tërësi për rregulloren për orarin e punës së bizneseve, përfshirë edhe kohëzgjatjen, datat dhe çështje tjera rreth diskutimit / debatit publik me qytetarë.

- Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozim vendimit për vënienë në diskutim publik Propozim Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, (sipas propozimeve të Ekzekutivit të Komunës)
- N'kuadër të vendimit, përkatësisht diskutimit/debatit publik të përfshihet në tërësi edhe Rregullorja bazë për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, (sipas rekomandimeve të miratuara nga Komiteti për Politikë dhe Financa) Rregullore për të cilën po ashtu mund të jepen propozime, sugjerime dhe vërejtje eventuale për plotësim ndryshim e saj.
- **Diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, përkatësisht nga data 15 mars 2021 deri më 15 prill 2021, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 22 mars 2021 duke filluar në ora 10;00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës.**

5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, siç jeni në dijeni është zhvilluar një procedurë e konkursit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës. Ashtu siç e parasheh ligji, periudha kohore e aplikimit është 2 javë me një ditë shtesë për shkak që dita e fundit e aplikimit ka qenë dita e diele.

Ne si Drejtori propozojmë që komisioni në fjalë ta ketë këtë përbërje: Blerim Vllasa zyrtar i arsimit, Nazif Sheqa, Kryetar i Këshillit të Prindërve, dhe nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesës që i'u kemi bërë më 19.01.2021 emrat e dërguar janë (siç edhe mund t'i shihni në dokumentin që sapo ju shpërnda), Fetah Kosumi, anëtar për nivelin arsimor fillorë dhe të mesëm të ulët, Sahit Berisha, anëtar për nivelin e arsimit të mesëm të lartë, dhe Imrane Ramadani, anëtare për nivelin e arsimit parashkollor, prandaj ju kërkoj që brenda mundësive t'i mbështetni këto propozime dhe t'i rekomandoni Kuvendit për shqyrtim në mënyrë që t'i rrugë zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Podujevës.

z.Arlinda Kadriu, theksoi, ne Grup i këshilltarëve të LDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim në seancën e thirrur për ditën e nesërme.

z.Florent Hasani, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e rekomandojmë për Kuvend këtë pikë të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po ashtu edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të kësaj pike.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës duke përfshirë edhe propozimet e drejtorit të DKA-së.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, përfshirë edhe propozimet e Drejtorisë së Arsimit dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për caktimin e anëtarëve në komisionin përkatës, dhe atë:

Nga Drejtoria e Arsimit;

- Blerim Vllasa, zyrtar për arsimin e mesëm të lartë
- Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve

Nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës; (sipas propozimeve me shkrim nga MASH)

- Fetah Kasumi, për nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm,
- Sahit Berisha, për nivelin e arsimit të mesëm të lartë,
- Imrane Ramadani, për nivelin e arsimit parashkollor,

6. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, për vitin 2020

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, lidhur me këtë KKSB ju jeni në dijeni që ka qenë një periudhë e qeverisjes së kaluar kështu që stafi i zyrës ligjore ka përgatitur informatën lidhur me aktivitetet për vitin 2020 dhe këtë informate e keni para vetës.

z.Mehmet Gashi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e përkrahi dhe deklaroi se e mbështesim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim të kësaj informate.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së po ashtu e përkrahi që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së deklaroi se informatë në fjalë e përkrahin për diskutim në mbledhjen e Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

7. Propozim Plan i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, për vitin 2021

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, meqë plani vjetor i punës është dërguar me kohë dhe është goxha voluminoz nuk po e shoh të arsyeshme që pikë më pikë ta lexojë, kështu që nesër në seancën e Kuvendit sigurisht që mund të diskutohet dhe të plotësohet-ndysohet.

z.Mehmet Gashi, theksoi, gjithashtu edhe për këtë pikë i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, kështu që nëse ka ndonjë pikë që planifikojmë ta përfshijmë në këtë plan, nesër mund ta paraqesim në Kuvend.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grupi i LVV-së e mbështesim që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, por kemi një kërkesë që nesër në seancë të jetë i pranishëm edhe Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë, pra ky është rekomandimi ynë.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, në kuadër të aktiviteteve të parapara në këtë propozim Plan, parashihet që patjetër në disa pika apo mbledhje të caktuara të jetë edhe Komandanti i Stacionit të Policisë, pavarësisht që është anëtar i KKSB-së, andaj ndoshta është mirë ta paralajmërojmë më herët

sepse ky është vetëm propozim plan dhe se çfarë planifikohet të realizohet, prandaj po e them që ndoshta është mirë që t'ia bëjmë një ftesë Komandantit në mënyrë që ai të këtë kohë dhe të punoj për të qenë përgatitur. Edhe me plan ka për të raportuar në KKSB dhe parashihet një gjë e tillë, por sërish po e lëm ashtu siç e vlerësoni ju si KPF dhe si Kuvend.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, Komandanti i Stacionit Policor në Podujevë, meqë është anëtar i KKSB, vetëm nëse është i zënë diçka sepse është dashur të asistoj në këto takime, të jetë prezent dhe ta pasuroj takimin por edhe planin me punët dhe aktivitetet tij, kështu që unë mund ta lajmëroj dhe ta njoftoj se është kërkesës e KPF-së dhe Kuvendit të jetë prezent nesër seancë, pra në cilësinë e Kryesuesit, edhe pse vendim apo ftesë të miratuar diçka për këtë çështje nuk kam për ta njoftuar.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me kërkesën që nga Kryesuesi i Kuvendit të ftohet që të jetë prezent në mbledhje edhe Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë.

8. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për subvencionimin e transportit të donacionit nga Shoqata “Human Bridge” me seli në Suedi

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, kjo çështje lidhet me një ofertë që e kemi nga një organizatë humanitare me seli në Suedi e cila na ka dhënë një ofertë të mirë subvencion në vlerë prej rreth 160,000.00 €, me kusht që ne si Komunë ta subvencionojmë transportin e tyre me një vlerë rreth 4,500.00€ deri në 5,000.00€, për çka ne kemi shprehur gatishmëri që transporti të subvencionohet dhe të pranohet malli – donacioni me instrumente dhe pajisje të ndryshme mjekësore prej Suedisë.

Shpresoj që e keni lexuar këtë pikë dhe besoj që do të përkrahet kjo sepse është në interes i përgjithshëm dhe e kalon shkallën politike sepse është humane mbi të gjitha, për çka e falënderojmë përfaqësuesin e organizatës së cekur. Vlen të theksohet se 2 komuna tjera e kanë pranuar një subvencion – donacion të tillë, Lipjani dhe Peja, dhe shpresoj që edhe ne kemi do ta pranojmë.

z.Mehmet Gashi, theksoi, ne e përshëndesim këtë çështje të tilla aq më shumë kur është në interes për qytetarët siç u prezantua ky donacionet. Sa i përket shumës për transport edhe këtë e përkrahim, mirëpo është përgjegjësi e Ekzekutivit ta specifikoj se sa do të jetë ajo shumë sepse me siguri saktësisht edhe nuk e din, po e them këtë sepse ne mund të marrim një vendim që është propozuar por saktësisht na duhet që të arsyetojmë tek financat prandaj edhe Ekzekutivi duhet t'i sqaroj pastaj ato.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, theksoi, ne e kemi bërë një parallogari dhe shuma sillet rreth 4,200.00€ deri në 5,000.00 €, pra do të thotë më pak se 5,000.00 € vlera e transportimit që na duhet ta mbulojmë, për specifika tjera besoj që do të jepen më shumë detaje me kohë edhe në seancën e Kuvendit mirëpo kur të sjellët dërgesa pastaj do ta shohim, pra nuk është diçka që mund të zhduket por vetëm do të mbulohet me pagesa dhe fatura, mirëpo saktë shumën nuk e dimë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, pasi e propozoj drejtori prej 4,000.00€ deri në 5,000.00€, duhet ta kemi parasysh që shuma e miratuar të jete 5,000.00 € sepse po të ndajmë më pak pastaj është problem të rindahen sërish mjete buxhetore për ta mbuluar, pra mund të jetë keq në aspektin teknik dhe juridik, kështu që nëse teprojnë ato mjete sërish mund të rikthehen dhe të ri ndahen në destinacion tjetër qofshin ato 400 € ose 500 €, ndërsa në qoftë se ne miratojmë shumë më të vogël dhe për pak mjete duhet miratim tjetër zyrtar për bartje të mjeteve. Sido që të jetë mbetet e drejtorit që të propozoj shumën por jo të shkohet, shembull 4,000.00€ deri në 5,000.00 € por duhet të miratojmë 5,000.00€, nëse shpenzimet janë më të vogla është më mirë, çka do që tepron i riallokojmë sërish.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, theksoi, ne kemi planifikuar 5,000.00 € si shumë totale maksimale, parallogaritë janë rreth 4,200.00€ deri 4,500.00€, mirëpo ne po kërkojmë 5,000.00€, pastaj ato që mbeten do t'i riallokojmë sërish diku tjetër.

z.Florent Hsani, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështet këtë nismë humane dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim sipas propozimeve të drejtorit parafolës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, është mirë që nga Ekzekutivi i Komunës të planifikohen mjete buxhetore për çështje të tilla sepse për çdo vit mund të kemi çështje - donacione të ngjashme, pra si sugjerim i imi për të ardhmen është që të parashihen me kohë mjete buxhetore

Nëse nuk ka dikush të shtoj diçka rreth këtij propozim vendimi, e hedh në votim duke përfshirë edhe propozimin e drejtorit të DSHMS rreth shumës së kërkuar prej 5,000.00€ për mbulimin – subvencionimin e shpenzimeve të transportit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, përfshirë edhe propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, që shuma financiare prej 4,000.00€ e paraparë në propozim vendimin përkatës, të ngritet në 5,000.00€

Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0022047/21

Podujevë,

09 mars 2021

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi